



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 08/L - 154**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT  
PËR STUDIMIN E FIZIBILITETIT DHE PROJEKT-IDESË PËR  
LIDHJEN HEKURUDHORE DURRËS -PRISHTINË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË  
BASHKËFINANCIMIT PËR STUDIMIN E FIZIBILITETIT DHE  
PROJEKT-IDESË PËR LIDHJEN HEKURUDHORE  
DURRËS -PRISHTINË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ratifikimi i “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë”.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i marrëveshjes**

1. Marrëveshja e Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës - Prishtinë, konsiderohet e ratifikuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Marrëveshja dhe shtojcat e saj janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-154**  
**21 korrik 2022**

**Glauk KONJUFCA**

---

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**